



GREEN COAST SHPK

Pasqyrat Financiare per Vitin ushtrimor 2015

INDIVIDUALE



PERMBAJTJA

1.	PASQYRA E SITUATES FINANCIARE	1
2.	PASQYRA E PERFORMANCËS (PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE).....	3
3.	PASQYRA E TE ARDHURAVE GJITHEPERFSHIRESE	4
4.	PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE.....	5
5.	PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL	6
6.	INFORMACIONE TE PERGJITHESHME	7
7.	BAZA E PREGATITJES SE PASQYRAVE FINANCIARE.....	7
8.	GJYKIMET, VLERESIMET DHE SUPOZIMET KONTABEL TE RENDESISHME.....	7
9.	POLITIKA TE RENDESISHME KONTABEL.....	7
10.	MJETE MONETARE	12
11.	TE DREJTA TE ARKETUESHME.....	12
12.	INVENTARI.....	12
13.	DETYRIMET AFATSHKURTRA	12
14.	TE PAGUESHME PER SHPENZIME TE LLOGARITURA	13
15.	TE TJERA SHPENZIME	13
16.	SHPENZIME TE PERSONELIT	13
17.	TE ARDHURA DHE SHPENZIME FINANCIARE	14
18.	SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIM	14
19.	NGJARJE PAS DATES SE BILANCIT.....	14
20.	PALET E LIDHURA	14
21.	PALET E LIDHURA FITIM HUMBJA 31.12.2015	15

GREEN COAST
PASQYRA FINANCIARE VITI 2015
(Vlerat ne ALL)

1. PASQYRA E SITUATES FINANCIARE

1. Pasqyra e Pozicionit Financiar (Balanci) 31 Dhjetor 2015		në lekë		
A	Zëri i Bilancit	Shënime	2015	2014
I	Aktivët Afatshkurtra		262,631,066.87	68,214,627.47
1	Mjete monetare	10	2,447,053.91	255,689.27
2	Investime :			
a)	Në tituj pronësie të njërive ekonomike brenda grupit		-	-
b)	Aksionet e veta		-	-
c)	Të tjera financiare		-	-
	Totali		-	-
3	Të drejta të arkëtueshme :			
a)	Nga aktiviteti i shfrytëzimit	11	137,280.00	20,000.00
b)	Nga njësitë ekonomike brenda grupit		137,280.00	-
c)	Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		-	-
d)	Të tjera		-	-
e)	Kapital i nënshkruar i papaguar		-	20,000.00
	Totali		-	-
4	Inventarët:		137,280.00	20,000.00
a)	Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme	12	260,046,732.96	67,938,938.20
b)	Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte	a)	486,075.20	486,075.20
c)	Produkte të gatshme	b)	249,152,798.93	67,452,863.00
d)	Mallra		-	-
e)	Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmëri)		-	-
f)	AAGJM të mbajtura për shitje		-	-
g)	Parapagime për inventar		-	-
	Totali	c)	10,407,858.83	-
			260,046,732.96	67,938,938.20
5	Shpenzime të shtyra			
6	Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara			
			-	-
			-	-
I-Aktive totale afatshkurtra				
II	Aktive Afatgjata		262,631,066.87	68,214,627.47
1	Aktive financiare:			
a)	Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit		-	-
b)	Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit		-	-
c)	Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		-	-
d)	Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		-	-
e)	Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjata		-	-
f)	Tituj të tjerë të huadhënies		-	-
	Totali		-	-
2	Aktivët materiale:			
a)	Toka dhe ndërtesa		-	-
b)	Impiante dhe makineri		-	-
c)	Të tjera Instalime dhe pajisje		-	-
d)	Parapagime për aktive materiale dhe në proces		-	-
	Totali		-	-
3	Aktive Biologjike			
4	Aktive jo materiale:			
a)	Koncesione, patenta, licenca, marka tregtare, të drejta dhe aktive të ngjashme		-	-
b)	Emri i Mirë		-	-
c)	Parapagime për AAJM		-	-
	Totali		-	-
5	Aktive tatimore të shtyra			
			-	-
II-Aktive totale afatgjata				
Aktive totale (I+II)			262,631,066.87	68,214,627.47

GREEN COAST
PASQYRA FINANCIARE VITI 2015

(Vlerat ne ALL)

2. PASQYRA E PERFORMANCËS (PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE)

N.r.	PËRSHKRIMI	Shenime	2015	2014
1	Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit			
2	Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces		-	-
3	Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar		-	-
4	Të ardhura të tjera të shfrytëzimit			
5	Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme			
a)	Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	15	(3,603,047.00)	(474,760.00)
b)	Të tjera shpenzime			
6	Shpenzime të personelit		(3,603,047.00)	(474,760.00)
a)	Paga dhe shpërblime	16	(3,454,584.00)	(1,522,572.00)
b)	Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore (paraqitur veçmas nga shpenzimet për pensionet)		(3,196,329.00)	(1,414,000.00)
c)			(258,255.00)	(108,572.00)
7	Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale			
8	Shpenzime konsumi dhe amortizimi			
9	Shpenzime të tjera shfrytëzimi			
10	Të ardhura të tjera		(2,855,859.32)	(170,693.81)
a)	Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)		-	-
b)	Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)			
c)	Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)			
d)	Të ardhura të tjera të shfrytëzimit			
11	Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra			
12	Shpenzime financiare			
a)	Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur veçmas shpenzimet për t'u paguar tek njësitë ekonomike brenda grupit)	17	2,705,012.22	(9,799.72)
b)	Shpenzime të tjera financiare		-	-
c)	Fitimet (humbjet) nga kembimet valutare			
13	Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet		2,705,012.22	(9,799.72)
	Fitimi/Humbja para tatimit		(7,208,478.10)	(2,177,825.53)
14	Shpenzimi i tatimit mbi fitimin			
a)	Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		-	-
b)	Shpenzimi i tatimit fitimit të shtyrë			
c)	Pjesa e tatimit fitimit të pjesëmarrjeve			
	Fitimi/Humbja e vitit		(7,208,478.10)	(2,177,825.53)
	Fitimi/Humbja për:			
	Pronarët e njësisë ekonomike mëmë		(7,208,478.10)	(2,177,825.53)
	Interesat jo-kontrolluese			-



GREEN COAST
PASQYRA FINANCIARE VITI 2015
(Vlerat ne ALL)

3. PASQYRA E TE ARDHURAVE GJITHEPERFSHIRESE

N.r.	PËRSHKRIMI	Shënime	në lekë	
			2015	2014
1	Fitimi/Humbja e vitit		(7,208,478.10)	(2,177,825.53)
2	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:		-	-
a)	<i>Diferencat (+/-) nga përktimi i monedhës në veprimtari të huaja</i>			
b)	<i>Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale</i>			
c)	<i>Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktivet financiare të mbajtura për shitje</i>			
d)	<i>Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet</i>			
	Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
3	Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		(7,208,478.10)	(2,177,825.53)
4	Totali i të ardhurave/humbjeve gjithëpërfshirëse për:			
	Pronarët e njësisë ekonomike mëmë		(7,208,478.10)	(2,177,825.53)
	Interesat jo-kontrolluese			



4. PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE

Sipas metodës indirekte . Indirect method			ne leke	
N.r.	P Ë R S H K R I M I	Shenime	2015	2014
A	Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit			
1	Fitim / Humbja e vitit			
2	Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		(7,208,478.10)	(2,177,825.53)
3	Shpenzime konsumi dhe amortizimi		-	-
4	Zhvlërësimi i aktiveve afatgjata materiale		-	-
5	Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		-	-
a)	Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		-	-
6	Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:			
a)	Rënie/(ritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera		(212,081,016.00)	(67,958,937.20)
b)	Rënie/(ritje) në inventarë			(67,958,937)
			(212,081,016.00)	
	Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		(219,289,494.10)	(70,136,762.73)
B	Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit			
8				
	Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		-	-
C	Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit			
1	Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar		70,045,680.00	100.00
2	Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral		151,435,178.50	70,392,352.00
	Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		221,480,858.50	70,392,452.00
	Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare		2,191,364.40	255,689.27
	Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare ne fillim te periudhes kontabel		255,689.27	
	Efkti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare		-	-
	Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare ne fund te periudhes kontabel		2,447,053.67	255,689.27



GREEN COAST
PASQYRA FINANCIARE VITI 2015
(Vlerat ne ALL)

5. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL

PËRSHKRIMI	Kapitali i nënshkruar	Primi i lidhur me kapitalin	Rezerva Rivlerësimi	Rezerva Ligjore	Rezerva Statutore	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali	Interesa Jo-Kontrollues	Totali
Pozicioni financiar më 31 Dhjetor 2013									-		-
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2014	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Fitimi / Humbja e vitit ushtrimor											
Emetimi i kapitalit të nënshkruar	100.00							(2,177,825.53)	(2,177,825.53)		(2,177,825.53)
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2014	100.00	-	-	-	-	-	-	(2,177,825.53)	100.00		100.00
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2015	100.00								(2,177,725.53)		(2,177,725.53)
Fitimi / Humbja e vitit ushtrimor											
Emetimi i kapitalit të nënshkruar	70,045,580.00							(2,177,825.53)	(2,177,725.53)		(2,177,725.53)
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2015	70,045,680.00	-	-	-	-	-	-	(7,208,478.10)	70,045,580.00		(7,208,478.10)
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2016	70,045,680.00	-	-	-	-	-	-	(9,386,303.63)	60,659,376.37		60,659,376.37
								(9,386,303.63)	60,659,376.37		60,659,376.37

Elton GJKA

Administratori



Green Coast



Altina DELJU

Departamenti Finance

**GREEN COAST
SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
VITI 2015**

(Vlerat ne ALL)

6. INFORMACIONE TE PERGJITHESHME

“Green Coast” sh.p.k (“Shoqeria”) eshte krijuar si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me date 29 Janar 2014 ne Qendren Kombetare te Regjistrimit me aksioner te shoqerise 100% “Balfin” shpk. Kapitali i shoqerise ne daten 31 Dhjetor 2015 eshte ne vleren 70,045,580 Leke

Objekti: Aktiviteti i shoqerise eshte Projektimi, ndertimi, venia ne shfrytezim, administrimi, mirembajtja, menaxhimi, operimi i Resorteve Turistike

Certifikimi tatimor: NIPT L41329038D

Forma juridike e shoqerise: Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar

Adresa e selise : Rruga Papa Gjon Pali II, ABA Business Center, Kati 11-te
Shoqeria kryen aktivitetin e saj ne ambjente qe jane te marra me qira.

Administrator i shoqerise eshte Z. Elton Gjika

7. BAZA E PREGATITJES SE PASQYRAVE FINANCIARE

Shoqeria i mban te dhenat e kontabilitetit dhe publikon pasqyrat e saj financiare te vitit 2015 ne bazë të Standardeve Kombëtare të Raportimit Financiar (“SKK”), të shpallura me Urdhërin e Ministrit të Financave Nr. 4292 datë 15.06.2006 dhe në përputhje me Ligjin mbi kontabilitetin no: 9228 datë 29 Prill 2004 “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në Lek shqiptar (“Lekë”), e cila është edhe monedha kryesore e mjedisit ekonomik, ku operon Shoqëria. Shifrat janë të rumbullakosura në Lekë.

Aktivitetet financiare dhe detyrimet financiare janë të kompensuara dhe shumat neto raportohen në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ka të drejtë ligjore për t’i kompensuar shumat e njohura dhe ka një përprjekje për t’i vendosur në bazë neto, ose për realizimin e aktiveve dhe shlyerjen e detyrimeve njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet nuk janë të kompensuara në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse pasi nuk kërkohet ose lejohet nga ndonjë standard i kontabilitetit ose interpretim, dhe ndonjë politikë kontabël e Shoqërisë.

8. GJYKIMET, VLERSIMET DHE SUPOZIMET KONTABEL TE RENDESISHME

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKK kërkon që Drejtimi të bëjë disa gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në raportimin e vlerave të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Vlerësimet dhe supozimet themelore rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi kryhet dhe në ndonjë periudhë të ardhshme, në të cilën ato ndikojnë. Informacioni mbi elemente të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykimeve kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt të rëndësishëm në vlerat e njohura në pasqyrat financiare janë paraqitur më poshtë.

9. POLITIKA TE RENDESISHME KONTABEL

(a) Transaksionet në monedhë të huaj

Rregjistrimet kontabël të njësisë janë të përgatitura në Lekë Shqiptar, e cila është edhe monedha kryesore e mjedisit ekonomik në të cilën operon shoqëria.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, transaksionet në monedhë të ndryshme nga monedha funksionale (monedha të huaja) rregjistrohen me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Në fund të çdo periudhe raportuese, mjetet monetare në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin e datës së raportimit që është kursi i këmbimit të Bankës së Shqipërisë më 31.12.2015, 1 Euro me 137.28 Lekë dhe 1 USD me 125.79 Lekë.

Mjetet jo monetare që mbahen me vlerë të drejtë që janë të rregjistruara në monedhë të huaj, rivlerësohen në kursin e datës kur përcaktohet vlera e drejtë. Mjetet jo monetare që maten me kosto historike në monedhë të huaj nuk rivlerësohen.

GREEN COAST
SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
VITI 2015

(Vlerat ne ALL)

Diferencat nga këmbimi njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse si fitim apo humbje në periudhën në të cilën ata ndodhin përveç diferencave të këmbimeve për huamarrjet në monëdhë të huaj të lidhura me aktivet në ndërtim për përdorim të ardhshëm, të cilat përfshihen në kostot e atyre aktiveve kur ato lidhen me një rregullim në koston e interesit të huamarrjeve në monëdhë të huaj.

(b) Instrumentat financiare

Shoqëria fillimisht i ka njohur llogaritë e arkëtueshme dhe depozitat në datën e krijimit të tyre. Të gjitha aktivet e tjera financiare (duke përfshirë edhe aktivet e vlerësuar me vlerën e drejtë) njihen në datën e tregtimit, datën kur shoqëria ka lidhur një kontratë për këto instrumenta. Shoqëria ç' rregjistron një aktiv financiar në momentin kur të drejtat kontraktuale për flukset nga këto aktive skadojnë, ose transferon të gjitha të drejtat për të përfituar flukset kontraktuale të të ardhurave të aktivit financiar me anë të një transaksioni, i cili transferon përfitimet dhe rreziqet që lidhen me pronësinë e aktivit. Ndonjë interes që është mbajtur apo krijuar mbi aktivet e transferuara nga shoqëria paraqitet më vete si një e drejtë apo detyrim. Detyrimet dhe të drejtat financiare kompesohen dhe paraqiten me vlerën neto në bilanc, vetëm kur shoqëria ka të drejtën ligjore për të kompensuar vlerat dhe ka për qëllim të shlyejë këto në vlerë neto, apo të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Instrumentat financiar jo derivativë të shoqërisë përfshijnë të drejta të tregtueshme dhe të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, detyrime të tregtueshme dhe të tjera

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj përfshijnë paratë në arkë dhe llogaritë rrjedhëse bankare, si dhe depozitat afatshkurtra me një maturitet tre mujor ose me pak. Për qëllime të pasqyres së flukseve monetare, mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre perbehen nga paraja dhe depozitat afatshkurtra të percaktuara më lart, pasi i zbritet teprica e paradhënive bankare.

Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit minus humbjet nga zhvlerësimi

Huamarrjet dhe parapagimet

Huatë e marra nga Institucionet Financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë, duke zbritur koston e transaksionit. Detyrimet financiare maten më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke njohur shpenzimin e interesit mbi bazën e interesit efektiv.

Metoda e normës efektive të interesit është një metodë për llogaritjen e koston së amortizuar të një detyrimi financiar dhe për alokimin e shpenzimeve të interesit përgjatë periudhës. Norma efektive e interesit është norma e cila skanton ekzaktësisht pagesat e ardhshme të vlerësuar përgjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose, ku është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër..

Llogaritëe pagueshme

Llogaritë e pagueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit

Te tjera


Instrumenta të tjera financiare jo derivative janë matur me koston e amortizueshme, duke përdorur metodën e normës së interesit efektiv, duke zbritur humbjet nga zhvlerësimet. *Kapitali aksionar*

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme janë klasifikuar si kapital.

(c) Aktivet Afatgjata investimi

Aktive afatgjata investimi, të cilat janë prona të mbajtura për të fituar të ardhura nga qeratat dhe / ose për rivlerësimin e kapitalit (duke përfshirë prona në ndërtim për qëllime të tilla), maten fillimisht me kosto, duke

8



GREEN COAST
SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
VITI 2015

(Vlerat ne ALL)

përfshirë koston e transaksionit. Ato njihen fillimisht në pasqyrën e pozicionit financiar në momentin që rreziket dhe përfitimet nga pronësia transferohen te shoqëria pavarësisht nga fakti nëse titulli është transferuar apo jo. Ato maten fillimisht me kosto. Pas momentit të njohjes, në vijim aktivet aftagjata investimi maten me modelin e koston. Aktivet aftagjata investimi, të cilat janë në proces ndërtimi të lidhura me projekte të reja me të cilat po merrt shoqëria, për ndërtimin e magazinave që do të jepen me qera ku përfshirja e shoqërisë në menaxhimin do të jetë minimale. Si e tillë, shoqëria po llogarit kostot direkte të ndodhura gjatë procesit të ndërtimit dhe sjelljes së aktivitetit në kushtet për tu dhënë me qera.

(d) Aktive aftagjata materiale

Njohja dhe matja

Aktivitet aftagjata materiale, maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostot përfshijnë shpenzimet që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe kosto të tjera që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë për sjelljen e aktivitetit në gjëndje pune për qëllimin që i është caktuar, kostot e çmontimit dhe lëvizjes së aktiveve dhe kthimin e vendodhjes së tyre në gjëndjen e mëparshme, si dhe kostot e kapitalizuara të huave. Kostot gjithashtu mund të përfshijnë zëra të transferuar nga të ardhurat të tjera përmbledhëse për fitime apo humbje të kualifikimit të flukseve të parasë të mbuluara nga blerjet në monëdhë të huaj të aktiveve aftagjata materiale. Blerja e programeve kompjuterike të cilat janë pjesë përbërëse e funksionimit të paisjeve aftagjata materiale. Blerja e asaj paisjeje. Në momentin që një nga aktivitet aftagjata materiale përbëhet nga përkatëse kapitalizohet si pjesë e asaj paisjeje. Në momentin që një nga aktivitet aftagjata materiale përbëhet nga pjesë me jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato rregjistrohen si pjesë të ndara nga njëra tjetra. Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve aftagjata materiale percaktohen duke krahasuar arkëtimet nga shitja me vlerën kontabël neto të aktivitet aftagjatë material dhe njihen neto në të ardhura ose humbje të tjera.

Kostot ne vijim

Kostot për zëvendësimin e një pjese të aktivitet aftagjatë material rregjistrohen me vlerën kontabël të aktivitetit në rast së është e mundur që përfitimet ekonomike në periudhat e ardhshme të përfshira në të të mund të rrjedhin tek shoqëria dhe kostoja të mund të matet me besueshmëri. Vlera e kontabël e pjesëve të ndërruara si rrjedhojë ç'rregjistrohet. Kostoja e shërbimit ditor, të vazhdueshëm të ndërtesave dhe paisjeve rregjistrohet tek fitimet ose humbjet kur ndodhin.

(e) Aktive aftagjata jomateriale

Njohja dhe matja

Aktivitet jomateriale të blera nga shoqëria maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe rënien në vlerë të akumuluar.

Kostot ne vijim

Kostot në vijim kapitalizohen vetëm kur ato rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike nga aktiviteti specifik me të cilat lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera, duke përfshirë shpenzimet e gjenerimit të emrit të mirë dhe markës, njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse (në humbje ose fitime) në momentin e ndodhjes.

(f) Zhvlerësimi

Aktivitet financiare

Një aktiv financiar që nuk mbahet me vlerën e drejtë, vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna objektive që ka pësuar rënie në vlerë. Një aktiv financiar bie në vlerë nëse ka të dhëna objektive të një ngjarje që ka çuar në rënien e vlerës së tij pas momentit fillestar të njohjes së aktivitetit, dhe kjo ngjarje ka efekt negativ në vlerësimin e flukseve të ardhshme nga aktiviteti të cilat mund të maten me besueshmëri.

Humbja nga rënia në vlerë e aktivitetit të vlerësuar me koston e amortizuar llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme që priten të gjenerohen nga ky aktiv financiar të aktualizuara me normën fillestare efektive të interesit. Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse (në humbje ose fitim) në një llogari zbritje kundër të arkëtueshmet. Interesi nga aktivitet e zhvlerësuar në këtë mënyrë vazhdon të njihet nëpërmjet amortizimit të skontos. Kur një ngjarje pasuese shkakton zvogëlimin e rënies në vlerë, shuma përkatëse rimerret nëpërmjet pasqyrës përmbledhëse të të ardhurave, fitimit ose humbjeve.

GREEN COAST
SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
VITI 2015

(Vlerat ne ALL)

Aktivitet jo financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo financiare të shoqërisë rishikohet në datën e raportimit për të përcaktuar nëse ka ndonjë të dhënë për rënie në vlerë. Nëse ekziston ndonjë evidence e tillë atëherë matet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Vlera e rikuperueshme është vlera më e madhe midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Gjatë vlerësimit të vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të vlerësuara skontohe në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqeve specifike të aktiveve që nuk janë marrë parasysh në vlerësimin e flukseve të ardhshme. Humbje nga rënia e vlerës njihet nëse vlera kontabël e aktivitetit ose e njësisë të tij të gjenerimit të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

(g) Perfitimet e punonjesve

Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore

Gjatë ecurisë normale të biznesit, Shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe të punonjesve për kontributet shoqërore dhe shëndetësore, të cilat janë të detyrueshme bazuar në legjislacionin. Këto kosto të kryera në emër të shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave dhe shpenziemve në momentin e ndodhjes.

Pensioni i detyrueshëm

Shoqëria, gjatë aktivitetit të saj, bën pagesa në emër të saj dhe në emër të punonjesve për të kontribuar në planin e pensionit sipas legjislacionit lokal. Kostot që ndodhin për këto plane i takojnë shoqërisë dhe ngarkohen në fitimin ose humbjen brenda vitit ushtrimor.

Leja e zakonshme e paguar

Shoqëria njihet si detyrim shumë e paskontuara të kostove të lidhura me lejen vjetore e cila pritet të paguhet në shkëmbim të shërbimit të ofruar nga punonjësi për periudhën.

(h) Provigjonet

Provigjoni njihet kur, si pasojë e ngjarjeve të kaluara, shoqëria ka detyrime aktuale ligjore apo konstruktive të cilat mund të vlerësohen me vërtetësi, dhe ka mundësi që të ketë nxjerrje të flukseve të ardhshme të parasë për të shlyer këtë detyrim. Provigjonet përcaktohen nga aktualizimi i flukseve të pritshme me një normë para tatimi që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të parasë dhe rrezikut specifik të detyrimeve.

(i) Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë flukset bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës të cilat gjenerohen përgjatë ecurisë normale të aktiviteteve të biznesit.

(j) Të ardhurat nga qeratë

Të ardhurat nga qeraja janë të ardhura të përfituara nga kontratat e qerasë, përveç të ardhurave të kushtëzuara të qerasë të cilat njihen kur përfitohen. Kostot fillestare direkte që ndodhin gjatë negociimit të një kontrate qeraje njihen si shpenzime në termat e qerasë me të njëjtat baza sit ë ardhurat nga qeraja.

Përpjekjet për të nënshkruar një kontratë qeraje janë shpërndarë në mënyrë të barabartë përgjatë afatit të kontratës së qerasë edhe nëse këto pagesa nuk bëhen në këto baza. Afati i qerasë është një periudhë e pa anulueshme qeraje së bashku me afate të tjera të mëtejshme për të cilat qeramarrësi ka opsionin për të vazhduar qeranë, kur, në fillim të qerasë drejtimi ka një siguri të arsyeshme që qeramarrësi do ta ushtrojë këtë opsion.

Shumat e marra nga qeramarrësi për përfundimin e qerasë ose kompesimin e përfundimit të saj njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse kur lind e drejta për ti marrë ato.

(k) Pagesat për qeranë financiare

Qeratë klasifikohen si qera financiare kur kushtet e qerasë transferojnë në mënyrë domethënëse të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë tek qeramarrësi. Të gjitha qeratë e tjera klasifikohen si qera operative. Pagesat e bëra për qeranë operative janë paraqitur në pasqyrën e të ardhurave në bazë lineare përgjatë kohëzgjatjes së kontratës

GREEN COAST
SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
VITI 2015

(Vlerat ne ALL)

Depozitimet e qeramarrësit

Detyrimet e depozitimeve të qeramarrësit fillimisht njihen me vlerë të drejtë dhe maten më kosto të amortizueshme kur është materiale. Diferencat ndërmjet vlerës fillestare të drejtë dhe shumës nominale përfshihet si një komponent i të ardhurave nga kontrata e qerasë dhe njihen në bazë lineare përgjatë kohëzgjatjes së kontratës.

(l) Te ardhurat financiare dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përbëhen nga të ardhurat nga interesi për fondet e investuara në depozita bankare dhe nga të ardhurat nga kursi i këmbimi.

Kostot financiare përbëhen nga shpenzimet e interesit të huave, shpenzime nga kurset e këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare në fitim dhe humbje nga rënia në vlerë e aktiveve financiare.

Humbjet apo fitimet nga kursi i këmbimit janë paraqitur në vlerë neto.

(m) Kostot e huamarrjes

Kostot e huave të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e aktiveve, të cilat duan një kohë të gjatë për t'u sjellë në formë përfundimtare, në mënyrë që të përdoren apo shiten, i shtohen kostos së këtyre aktiveve, deri në momentin kur këto aktive janë gati për qëllimin e tyre për përdorim ose për shitje.

Të ardhurat nga investimet e përkohshme, për sa i përket disa huave të veçanta, të cilave ende nuk ju është paguar interesi, kjo shumë ju zbritet kostove të huamarrjes dhe nuk i kapitalizohet koston së aktivitetit.

Të gjitha kostot e tjera njihen si të ardhura ose shpenzime në periudhën kur ato kanë ndodhur.

(n) Taksat

Tatimi mbi fitimin nënkupton tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përveç rasteve kur lidhen me zera të njohur direkt në kapital, në të cilat regjistrohen direkt në kapital.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm, i pagueshëm mbi fitimin e tatueshem për vitin, duke përdorur normat e tatimeve në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e bilancit, duke paraqitur për diferencat e përkohshme midis vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato të kthehen, bazuar në ligjet që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit.

Një aktiv i tatimit të shtyrë njihet nëse është e mundshme që të ardhurat e ardhshme të tatueshme do të realizohen kundrejt të cilave diferencat e përkohshme mund të përdoren. Aktivitetet e tatimit të shtyrë rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri sa nuk janë më të mundshme që përfitimet tatimore të lidhura me të do të realizohen.

(o) Ngjarjet pas datës së bilancit

Ngjarjet pas datës së raportimit, të cilat ofrojnë dëshmi për kushtet që ekzistojnë në datën e raportimit, trajtohen si ngjarje të korigjueshme në këto pasqyra financiare. Ata që janë tregues të kushteve që lindin pas datës së raportimit janë trajtuar si ngjarje të pakorigjueshme.

**GREEN COAST
SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
VITI 2015**

(Vlerat ne ALL)

10. MJETE MONETARE

Ne kete ze perfshihen mjetet monetare gjendje ne date 31.12.2015, ne llogarite rrjedhese prane bankave te nivelit te dyte. Per njohjen fillestare te ketyre elementeve si dhe per gjendjet, eshte perdorur politika kontabel e "vleres se drejte".

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
a) Vlera ne arke		
a.1 -Vlera ne leke ne arke	171,947	77
b.2 -Vlera ne euro ne arke	-	-
	171,947	77
b) Vlera ne banke		
b.1 - Vlera ne lek ne banke	421,436	79,162
b.2 - Vlera ne euro ne banke	1,853,671	176,450
TOTAL	2,275,107	255,612
	2,447,054	255,689

11. TE DREJTA TE ARKETUESHME

Ne kete post paraqitet detyrimi I klientit Dhermiu Development referuar kontrates ,vlera 137,280 Leke .

Të drejta të arkëtueshme :

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Kliente	137,280	-
Totali	4,859,441	511,302

12. INVENTARI

Ne kete post perfshihen zerat e detajuar te investimit ne proces .

Ne zerin prodhim ne process paraqiten te gjitha kostot per investime ne proces per projektin ne vleren 249,152,799 Leke .Zeri 'Parapagime per inventar paraqet parapagimet e kryera nga ndaj furnitorit Gjiguria sipas kontrates ndermjet paleve.

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
a) Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme	486,075	486,075
b) Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte	249,152,799	67,452,863
c) Parapagime për inventar	10,407,859	-
Totali	260,046,733	67,938,938

13. DETYRIMET AFATSHKURTRA

Posti "Detyrime afatshkurtra" jepet i detajuar si meposhte:

GREEN COAST
SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
VITI 2015

(Vlerat ne ALL)

Zeri "Detyrime per furnitore" : Ne kete grup perfshihen detyrimet e pagueshme ndaj furnitoreve te cilet ne njohje fillestare jane vleresuar me kosto. Vlera e ketij detyrimi eshte 41,955,419 Leke .
 Zeri "Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit" perfaqeson detyrimin e kompanise ndaj ortakut dhe paleve te treta . Vlera e ketij detyrimi 159,674,583 Leke.
 Zeri "Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore" perfaqeson detyrimin e shoqerise per pagen e administratorit , e cila do te paguhet ne muajin Janar 2016 .
 Zeri "Te pagueshme per detyrime tatimore " perfaqeson detyrimin e kompanise per sigurimet shoqerore dhe TAP muaji Dhjetor 2015. Ne kete ze, eshte zbritur parapagimi i keshtit te tatim fitimit

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Furnitore		
Furnitore per sherbime	41,719,911	565,640
a) Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	41,955,419	565,640
Ortaku		
b) Të pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit	159,674,583	19,863,438
Paga		
c) Të pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shëndetsore	232,749	232,750
Sigurime shoqerore		
Tatim per pagat	66,680	28,505
Parapagim tatim fitimi	74,663	27,720
d) Të pagueshme për detyrimet tatimore	(60,000)	(20,000)
	81,343	36,225

14. TE PAGUESHME PER SHPENZIME TE LLOGARITURA

Ne kete ze eshte paraqitur njohja e shpenzimit te telefonise celulare per muajin Dhjetor 2015:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		
Shpenzime te llogaritura	27,597	-
Totali	27,597	-

15. TE TJERA SHPENZIME

Zëri "Te tjera shpenzime" eshte pasqyruar ne vlerën 3,603,047 Leke, e detajuar si me poshte:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Shpenzime noteriale dhe ligjore		
Qera	80,700.00	257,300.00
Shpenzime te tjera per sherbime	27,943.00	139,960.00
Shpenzime per pritje, dhurata dhe sponsorizime	2,909,404.00	12,000.00
Totali	585,000.00	65,500.00
	3,603,047	474,760

16. SHPENZIME TE PERSONELIT

Shoqeria per vitin 2015 ka kryer shpenzime per personelin e saj sipas zerave perkates te detajuar si meposhte :

**GREEN COAST
SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
VITI 2015**

(Vlerat ne ALL)

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Shpenzime per paga	3,196,329	1,414,000
Sigurime shoqerore	258,255	108,572
Totali	3,454,584	1,522,572

17. TE ARDHURA DHE SHPENZIME FINANCIARE

Ne kete ze jane perfshire te ardhurat nga interesi i depozites dhe humbjet nga kembimet valutore.

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Shpenzime financiare		
Fitim nga konvertimi/kursi i kembimit	2,964,458.00	18,323.28
Humbje nga korvetimi/kurset e kembimit	(259,445.78)	(28,123.00)
	2,705,012	(9,800)

18. SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIM

Shpenzimi i tatim fitimit i llogaritur për vitin ushtrimor 2015 bazohet në detyrimin për tatim fitimit sipas Legjislacionin Fiskal në Shqipëri. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 është 15%. Niveli taksimit për fitimin zbatuar në vitin paraardhës 2014 ka qënë 15%. Në vlerë nominale, tatim fitimi i llogaritur për vitin ushtrimor është 0 (zero) Lekë.

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Shpenzim Tatim Fitimi		
Te ardhura Total	2,964,458	18,323
Shpenzime Total	10,172,936	2,196,149
Fitim (Humbja) para tatimit	(7,208,478)	(2,177,826)

19. NGJARJE PAS DATES SE BILANCIT

Pas datës së bilancit kontabël nuk ka ngjarje te ndodhura që kane ndikuar në rezultatin financiar të vitit ushtrimor.

Shoqëria pritet qe ne vitin 2016 te zhvilloje me tej aktivitetin e saj.

20. PALET E LIDHURA

Shoqëria ka realizuar gjatë vitit ushtrimor transaksione me palët e lidhura duke kryer marrëdhie blerje, si dhe duke krijuar të drejta dhe detyrime me këto palë. Tek këto palë përfshihen kompania mëmë Balfin Shpk, dhe shoqëritë grupit. Tabela më poshtë paraqet balancat për këto marrëdhënie në datë 31.12.2015 në postet e bilancit:

1. Pasqyra e Pozicionit Financiar (Balanci) 31 Dhjetor 2015			
	Zëri i Bilancit	Balfin	Neptun
A	AKTIVET	100.00%	
		-	-



GREEN COAST
SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
VITI 2015

(Vlerat ne ALL)

I-Aktive totale afatshkurtra		-	-
II	Aktive Afatgjata	-	-
II-Aktive totale afatgjata		-	-
Aktive totale (I+II)		-	-
B	DETYRIME DHE KAPITALI		
I	Detyrimet afatshkurtra	159,729,494.60	650,500.00
		159,729,494.60	650,500.00
I	Detyrime afatshkurtra:	159,729,494.60	650,500.00
a)	<i>Titujt e huamarrjes</i>	-	-
b)	<i>Detyrime ndaj institucioneve të kredisë</i>	-	-
c)	<i>Arkëtimet në avancë për porosi</i>	-	-
d)	<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>	-	-
e)	<i>Dëftesa të pagueshme</i>	54,912.00	650,500.00
f)	<i>Të pagueshme ndaj njësisë ekonomike brenda grupit</i>	159,674,582.60	-
	Totali	159,729,494.60	650,500.00
I-Totali i Detyrimeve afatshkurtra		159,729,494.60	650,500.00
II-Totali i Detyrimeve afatgjata		159,729,494.60	650,500.00
Detyrime totale(I+II)		-	-
		159,729,494.60	650,500.00
III	Kapitali dhe Rezervat	-	-
III-Totali i Kapitalit		-	-
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		159,729,494.60	650,500.00

21. PALET E LIDHURA FITIM HUMBJA ME 31.12.2015

N.r.	PËRSHKRIMI	Balfin	Neptun
5	Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	100.00%	
a)	<i>Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme</i>	140,036.00	585,000.00
b)	<i>Të tjera shpenzime</i>	-	-
6	Shpenzime të personelit	140,036.00	585,000.00
10	Të ardhura të tjera	-	-
12	<i>Shpenzime financiare</i>	-	-
Fitimi/Humbja para tatimit		-	-
14	Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	140,036.00	585,000.00
a)	<i>Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin</i>	21,005.40	87,750.00
Fitimi/Humbja e vitit		21,005.40	87,750.00
	Fitimi/Humbja për:	161,041.40	672,750.00
	Pronarët e njësisë ekonomike mëmë		
	Interesat jo-kontrolluese	161,041.40	672,750.00
		-	-

SHTOJCA E
PASQYRAVE FINANCIARE
PER VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2015

- Shtojca A Paga dhe Sigurime shoqerore per vitin 2015
- Shtojca B Furnitor – Gjendje Analitike
- Shtojca C Deklarata per hartimin e Pasqyrave Financiare 2015



List pagesa e kontributeve te sigurimeve shoqerore, shendetsore & Tatimit mbi te Ardhurat nga punesimi
Green Coast 2015 Periudha tatimore 2015

Shtojca A

Nr	6) Muaji	7)	NR/PUNJ	9) Dite kalendarike te	Paga bruto ne leke		Kontribute per sigurimet shoqerore ne			16) Kontribute per sigurimet shendetsore gjithsej ne leke	17) Paga bruto mbi te cilen llogaritet Tatimi mbi te ardhurat nga punesimi	18) Tatimi mbi te ardhurat nga punesimi ne leke	PAGA NETO	
					Gjithsej	11) Mbi te cilen llogariten kontributet	12) Gjithsej = (13 + 14 + 15)	Nga keto:						
								13) Puncdhensesi	14) Puncemarrjes					15) Kontribut shtese
1	JANAR				194,000	97,030	23,772	14,554.50	9,218		6,596	97,030	27,720	153,764
2	SHKURT				194,000	97,030	23,772	14,554.50	9,218		6,596	97,030	27,720	153,764
3	MARS				194,000	97,030	23,772	14,554.50	9,218		6,596	97,030	27,720	153,764
4	PRILL				194,000	97,030	23,772	14,554.50	9,218		6,596	97,030	27,720	153,764
5	MAJ				194,000	97,030	23,772	14,554.50	9,218		6,596	97,030	27,720	153,764
6	QERSHOR				194,000	97,030	23,772	14,554.50	9,218		6,596	97,030	27,720	153,764
7	KORRIK				194,000	97,030	23,772	14,554.50	9,218		6,596	97,030	27,720	153,764
8	GUSHT				194,000	97,030	23,772	14,554.50	9,218		6,596	97,030	27,720	153,764
9	SHTATOR				194,000	97,030	23,772	14,554.50	9,218		6,596	97,030	27,720	153,764
10	TETOR				341,958	97,030	23,772	14,554.50	9,218		11,627	97,030	61,750	265,177
11	NENTOR				471,287	194,060	47,545	29,109.00	18,436		16,024	194,060	74,663	370,176
12	DHJETOR				489,126	211,899	51,915	31,784.85	20,130		16,630	211,899	74,663	386,017
	Shuma		-		3,196,329	1,376,259	337,183	206,439	130,745	0	108,675	1,376,259	494,586	2,516,661
	Nr mesatar		-						#					

KONTRATE NËNQIRAJE

Kjo Kontratë Nënqiraje (në vijim referuar si "Kontrata") lidhet sot, në datën 29.01.2014 (dymijë e katërbëdhjetë), nga dhe ndërmjet Palëve të mëposhtme:

- Shoqërisë Balfin Sh.p.k., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar dhe regjistruar në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, e themeluar në Tiranë, në datën 11.09.2007 dhe e regjistruar në regjistrin tregtar me NUIS/NIPT K72223031K, me seli në adresën "Rr. Papa Gjon Pali II, ABA Business Center, Kati 12-të, Tiranë, Shqipëri", e përfaqësuar ligjërisht nga Përfaqësuesi i saj ligjor, Z. Samir MANE (më tek referuar si "Qiradhënësi")

dhe

- Shoqërisë Green Coast Sh.p.k., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar dhe regjistruar në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, e themeluar në Tiranë, në datën 29.01.2014 dhe e regjistruar në regjistrin tregtar me NUIS/NIPT L41329038D, me seli në adresën "Rr. Papa Gjon Pali II, ABA Business Center, Kati 12-të, Tiranë, Shqipëri", e përfaqësuar ligjërisht nga Përfaqësuesi i saj ligjor, Z. Ervin KAJNO (më tek referuar si "Nënqiramarrësi")

Palët në këtë Kontratë bien dakord për sa më poshtë vijon:

MEQENËSE

- A. Qiradhënësi ka lidhur një Marrëveshje Qiraje me Nr. 040110-OLA-1206, datë 14.01.2010 ndryshuar me Amendimin Nr. 1, datë 13.01.2014 me shoqërinë Gener 2 Sh.p.k. (NUIS/NIPT KS8615301M) me objekt marrjen me qira të zyrave me Nr. 1 në katin e 12-të teknik me sipërfaqe 134.55 m², Nr. 6 në katin e 12-të teknik me sipërfaqe 145.94 m², Nr. 7 në katin e 12-të teknik me sipërfaqe 143.41 m² (më tej referuar bashkarisht si "Zyra 1206" me sipërfaqe të përgjithshme 424 m²);
- B. Qiradhënësi ("Balfin" Sh.p.k.) merr përsipër të marrë miratimin me shkrim nga Shoqëria Gener 2 Sh.p.k. për dhënien me nënqira të një prej zyrave si më sipër tek Nënqiramarrësi ("Green Coast" Sh.p.k.). Shkresa e miratimit të marrëdhënies së nënqirasë do t'i bashkëlidhet kësaj Kontrate duke u bërë pjesë përbërëse dhe e pandashme e saj;
- C. Qiradhënësi dhe Nënqiramarrësi shprehin vullnetin e tyre për krijim e kësaj marrëdhënie Nënqiramarrje sipas kushteve dhe termave të mëposhtme

1- OBJEKTI I KONTRATËS

- 1.1 Qiradhënësi i jep me nënqira Nënqiramarrësit një pjesë të Zyrës me Nr. 1 në katin e 12-të teknik me një sipërfaqe prej 5 (pesë) m² (nga sipërfaqja totale e Zyrës 134,55 m²) në adresën "Rr. Papa Gjon Pali II, ABA Business Center, Kati 12-të, Tiranë, Shqipëri (më tej referuar si "Ambienti")

1.2 Qiradhënësi jep me nënqira Ambientin bosh dhe të pamobiluar, por duke përfshirë instalimet elektrike, lysterjen, sistemin e Ajrit të Kondicionuar (HVAC), infrastrukturën e telekomunikacionit (telefon, internet, etj), të cilat në çdo rast do të përdoren nga Nënqiramarrësi.

1.3 Nënqiramarrësi deklaron në mënyrë të shprehur se Ambienti objekt nënqiramarrje do të përdoret vetëm për Zyrë në përbushje të qëllimeve të aktivitetit tregtar të Nënqiramarrësit.

2- KOHËZGJATJA E KONTRATËS

2.1 Afati i kësaj kontrate është [1] (një) vjeçar me efekt nga data e nënshkrimit të saj nga Palët.

2.2 Ky afat fillon më 29.01.2014 me të drejtë rinovimi për të njëjtin afat, me kushtin që Kontrata e Qirasë mes shoqërisë "Balfin" Sh.p.k. dhe shoqërisë "Gener 2" Sh.p.k. do të vazhdojë të jetë në fuqi. Kjo Kontratë Nënqiraje do të konsiderohet si e rinovuar me të njëjtat kushte, nëse Qiradhënësi nuk e njofton me shkrim Nënqiramarrësin mbi synimin e tij për të mos rinovuar këtë Kontratë të paktën 1 (një) muaj para përfundimit të afatit të parashikuar më sipër.

3- PËRDORIMI I AMBIENTIT OBJEKT NËNQIRAJE

3.1 Ambienti merret me nënqira nga Nënqiramarrësi për t'u përdorur për Zyrë në ushtrim të aktivitetit të tij tregtar.

4- DORËZIMI I AMBIENTIT

4.1 Qiradhënësi do t'ia dorëzojë Ambientin Nënqiramarrësit në datën e fillimit të Kontratës së Nënqirasë. Me qëllim identifikimin e gjendjes së Ambientit, palët, para lidhjes së kësaj Kontrate, do të kryejnë një inspektim të plotë të Ambientit.

4.2 Në rast se Qiradhënësi nuk dorëzon Ambientin në kushtet dhe afatet e përcaktuara në këtë Kontratë, Nënqiramarrësi ka të drejtë të përfundojë menjëherë Kontratën e Nënqirasë duke njoftuar me shkrim Qiradhënësin dhe duke u larguar nga Ambienti. Qiradhënësi përjashtohet nga kjo përgjegjësi vetëm kur dorëzimi i Ambientit pengohet pa arsyë nga Nënqiramarrësi. Në përfundim të Kontratës së Nënqirasë, Nënqiramarrësi lejohet nga Qiradhënësi marrë me vete të gjitha pajisjet që janë instaluar në Ambientin objekt qiraje nga Nënqiramarrësi ose që janë instaluar me shpenzimet e tij gjatë kohës së nënqiramarrjes (përfshirë centralin telefonik dhe sistemin e alarmit, nëse ka të tilla).

4.3 Me përfundimin e Kontratës së Nënqirasë, Nënqiramarrësi do t'ia dorëzojë Ambientin Qiradhënësit menjëherë, në kushte të mira, të pastër, së bashku me çelësat dhe modifikimet, përmirësimet dhe ndryshimet, që mund të jenë bërë dhe nuk janë kërkuar të hiqen nga Qiradhënësi.

5- **NËNQIRAJA, MËNYRA E PAGESËS.**

5.1 Çmimi mujor i nënqirasë për përdorimin e Ambientit objekt qiraje është në total 100 (njëqind) Euro.

Në këtë shumë përfshihen: Qiraja + Taksa shtetërore.

5.2 Çmimi mujor i qirasë do të paguhet në llogarinë bankare të Qiradhënësit sipas të dhënave të mëposhtme brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve të para të çdo muaji kundrejt lëshimit të faturës përkatëse.

Emri i Bankës: Raiffeisen Bank në Tiranë, Shqipëri;
Nr. llogarisë: 4300905842 (ALL)
IBAN: AL 66202110370000004300905842 (ALL);
Kodl SWIFT: SGSBALTX

6- **TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRADHËNËSIT**

6.1 Përveç detyrimeve të parashikuara në dispozitat e tjera të kësaj Kontrate, palët, gjatë afatit të qirasë, garantojnë njëra-tjetrën se:

- a. Ambienti objekt qiraje nuk ka asnjë të metë dhe se ai është në gjendje të mirë. Qiradhënësi nuk do të hyjë në Ambientin e dhënë me nënqira në asnjë moment dhe për asnjë arsye, pa pëlqimin me shkrim të Qiramarrësit;
- b. Qiradhënësi garanton Qiramarrësin nga shqetësimet dhe/ose pretendimet e të tretëve në lidhje me Ambientin. Në rast të konstatimit të ndonjë mosmarrëveshje për Ambientin ndërmjet Qiramarrësit dhe një personi të tretë, Qiradhënësi detyrohet t'a zgjidhë atë, duke kapërcyer çdo lloj pengese që pengon Qiramarrësin në përdorimin e Ambientit në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate.
- c. Qiradhënësi do të kujdeset me shpenzimet e veta për Ambientin gjatë afatit të qirasë, duke përfshirë kujdesin ndaj të gjithë përbërësve strukturalë thelbësorë dhe do t'i mbajë ato në kushte të mira dhe të përdorshme, përveç rasteve kur dëmet shkaktohen nga neglizhenca e Nënqiramarrësit.
- d. Qiradhënësi do të kërkojë pagesën mujore të çmimit të nënqirasë sipas përcaktimeve të Nenin 5 më sipër.

6.2 Përgjatë gjithë periudhës së nënqirasë, Qiradhënësi ka detyrimin të mbajë të gjitha instalimet e fiksuara për përdorim të përbashkët dhe hapësirat e tjera, si muret e jashtme, në kushte të plota operimi. Të gjitha riparimet e nevojshme të tyre do të bëhen nga Qiradhënësi. Në rast se Ambienti ose instalimet prishen ose bëhen të papërdorshme tërësisht ose pjesërisht për shkak të defekteve në strukturë ose defekteve të fshehura në ndërtesë ose në instalime, ose për shkaqe mbi të cilat Nënqiramarrësi nuk ka kontroll, Nënqiramarrësi duhet të njoftojë Qiradhënësin në mënyrë që Qiradhënësi të procedojë për riparim të menjëhershëm.

6.3 Në rast se Qiradhënësi nuk fillon riparimin e tyre brenda 7 (shtatë) ditëve duke filluar nga data e marrjes së njoftimit, Nënqiramarrësi mund: a) me iniciativën e tij mund të procedojë me riparimin duke ia ngarkuar pagesën Qiradhënësit dhe kjo pagesë do të zbritet nga pagesa e qirasë, b) të zgjidhë menjëherë Kontratën e Nënqirasë duke njoftuar me shkrim Qiradhënësin dhe duke u larguar nga Ambienti.

7- TË DREJTAT DHE DETYRIMET E NËNQIRAMARRËSIT

7.1 Nënqiramarrësi angazhohet që gjatë afatit të nënqirasë të mos i japë me nën-qira Ambientin tek të tretët, të kalojë këtë Kontratë Nënqiraje tek palë të treta apo t'a përdorë Ambientin për qëllime të jashtëligjshme ose të ndryshme nga ai i përcaktuar në Nenin 3 më sipër.

7.2 Nënqiramarrësi është i detyruar të njoftojë me shkrim për ndryshimet që do të bëhen për efekt të përdorimit të Ambientit (një shtojcë të detajuar, të miratuar nga Qiradhënësi, me të dhënat e mundshme që do të nevojiten për të përshtatur Ambientin sipas biznesit që do përdoret, do t'i bashkëngjitet kësaj Kontrate para nënshkrimit të saj).

7.3 Gjatë afatit të qirasë, Nënqiramarrësi ka të drejtë të bëjë ndryshime, instalime dhe shenja brenda Ambientin objekt nënqiraje. Këto ndryshime të Ambientit nga ana e Nënqiramarrësit do të bëhen me miratimin me shkrim nga Qiradhënësi.

Nënqiramarrësi, me kërkesë të Qiradhënësit, do t'a kthejë Ambientin në gjendjen e mëparshme (ashtu siç e ka marrë në momentin e lidhjes së kësaj Kontrate), përveç dëmeve të arsyeshme që vijnë si rezultat i konsumit të zakonshëm ose elemente apo rrethana të cilat janë jashtë kontrollit të Nënqiramarrësit.

7.4 Nënqiramarrësi do t'a mbajë Ambientin në gjendje të mirë dhe në çdo rast, në kushte të përshtatshme për përdorimin e caktuar. Nënqiramarrësi duhet të sigurojë gjithashtu: mirëmbajtjen e përditshme të Ambientit, dhe të sistemit të ujërave të bardha dhe/ose të zeza dhe të linjës elektrike dhe/ose telefonike, të sistemit të kondicionimit së Ambientit dhe shpenzimet e zakonshme

7.5 Nënqiramarrësi do të përdorë në mënyrë të rregullt Ambientin, duke mbajtur përgjegjësi për kompensimin e dëmeve dhe humbjeve që mund t'i ndodhë Ambientit nga Nënqiramarrësi ose punonjësit e tij, përveç rasteve të amortizimit normal të tij. Për më tepër, Nënqiramarrësi është i detyruar të mbajë Ambientin të postrër dhe pa ndikuar në qetësinë, shëndetin, punën, sigurinë dhe moralin e qiramarrësve të tjerë (nëse ka të tilla).

7.6 Çdo modifikim, riparim ose përshtatje e Ambientit objekt nënqiraje nuk është i lejueshëm pa miratimin me shkrim të Qiradhënësit dhe pa miratimin e Planit përkatës nga ky i fundit.

7.7 Nënqiramarrësi do të marrë masat e duhura për të mbajtur në gjendje të mirë, të riparojë, dekorojë, lyejë, pastrojë si dhe të inspektojë mjediset e përbashkëta, rrugët hyrëse, rrugët e shërbimeve, parkingun, mjetet dhe rrugët e lëvizjes (korridoret, ashensorët, shkallët e emergjencës) etj., të cilat janë në shërbim të të gjithë qiramarrësve

8- SHËRBIMET OPERACIONALE DHE KOSTOT

8.1 Nënqiramarrësi do të paguajë çdo taksë apo tatim në ngarkim të tij (nëse ka të tilla) të parashikuara nga legjislati në fuqi gjatë periudhës së qirasë.

8.3 Shërbimet shtesë në lidhje me postrimin e mjediseve të brendshme të Ambientit objekt nënqiraje, të ofruara nga Qiradhënësi, do të rregullohen sipas marrëveshjeve të veçanta midis Palëve.

9- PËRFUNDIMI dhe ZGJIDHJA I/E KONTRATËS SË NËNQIRASË

9.1 Kontrata e nënqirasë përfundon në afatin e përcaktuar në Nenin 2 si më sipër.

9.2 Kontrata e nënqirasë përfundon në rast se Kontrata e Qirasë mes Balfin Sh.p.k. dhe Gener 2 zgjidhet ose shpallet e pavlefshme. Në këtë rast, palët do të zgjidhin pasojat që i shkaktohen Nënqiramarrësit.

9.3 Qiradhënësi ka të drejtë të zgjidhë Kontratën me anë të një njoftimi paraprak me shkrim nëse Nënqiramarrësi shkel një ose disa detyrime të Kontratës.

9.4 Nëse Kontrata zgjidhet për për shkelje/mospërbushje të Nënqiramarrësit, ai [nënqiramarrësi] do të paguajë një penaltit të barabartë me çmimin e nënqirasë së një muaji.

9.5 Nënqiramarrësi ka të drejtë të zgjidhë Kontratën me anë të një njoftimi paraprak me shkrim nëse Qiradhënësi shkel një ose disa detyrime të Kontratës.

9.6 Nëse Kontrata zgjidhet nga Nënqiramarrësi, ai liron menjëherë Ambientin objekt nënqiraje.

9.7 Nëse Ambienti ose ndonjë pjesë e tij do të dëmtohen nga zjarri, tërmeti, lufta ose shqetësime civile ose raste të tjera, Nënqiramarrësi ka të ketë të drejtë të zgjidhë menjëherë Kontratën me anë të një njoftimi me shkrim dërguar brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas zjarrit ose ngjarjes në fjalë. Në këtë rast Qiradhënësit nuk do t'i paguhet asnjë qira për shkak të zgjidhjes së Kontratës për ndonjë nga këto arsye.

10- TË NDRYSHME

10.1 Çdo ndryshim i kushteve të kësaj Kontrate do të bëhet me shkrim.

10.2 Kjo Kontrate zbatohet dhe interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë. Për çdo çështje, rregullimi i së cilës nuk parashikohet nga kjo Kontratë, do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

10.3 Të gjitha njoftimet dhe dokumentacionet e kërkuara sipas Kontratës do të dërgohen nga Qiradhënësi dhe Qiramarrësi në adresat e mëposhtme:

QIRADHËNËSI: Balfin sh.p.k.

Rr. Papa Gjon Pali II, ABA Business Center, Kati 12-të, Tiranë, Shqipëri

Person kontakti: Znj. Vjollca Ndrejani

Tel: _____ E-mail: info@balfin.al

NËNQIRAMARRËSI: Green Coast sh.p.k.

Rr. Papa Gjon Pali II, ABA Business Center, Kati 12-të, Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të Z. Ervin Kajno

Tel: _____ E-mail: _____

10.4 Mosmarrëveshjet e llojeve të ndryshme midis palëve zgjidhen me mirëkuptim midis tyre. Në rast të kundërt, këto konflikte zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Për sa më sipër, Palët me vullnetin e tyre të lirë, nënshkruajnë këtë Kontratë në ditën dhe vitin e përmendur më sipër.

PËR QIRADHËNËSIN:
SHOQËRIA Balfin SHPK


Samir MANE



PËR NËNQIRAMARRËSIN:
SHOQËRIA Green Coast SHPK


Ervin KANO



**FORMULAR I DEKLARIMIT DHE
PAGESES SE TATIMIT MBI FITIMIN**



(2) Periudha tatimore

15-A

(1) Numri Serial: _____

Numri i Vendosijes se Dokumentit (NVD)
(Vetem per perdorim zyrtar)

Numri Identifikues i Personit te Tatueshem (NIPT):

(3) L41329038D

Emri Tregtar i Personit te Tatueshem:

(4) GREEN COAST

Emri Mbiemri i Personit Fizik:

(5) _____

Adresa:

(6) Njesia Bashkiake nr.2, Rruga Papa Gjon Pali II, Aba
Business Center, Ndertesa nr.12, kati 11

Qyteti/Komuna/Rrethi:

Tirana, Tirane, Tirane

Numri Telefonit:

(7) _____

Lajmëroni nëse informacioni i mësipërm është jo i plotë ose ka ndryshuar

Llogaritja e rezultatit

Te ardhurat dhe shpenzimet

(8/9) Te ardhurat

(10/11) Shpenzimet

(12) Shpenzimet e pazbritshme

Rezultati

(13/14) Humbja

(15/16) Fitimi

(17) Humbje e mbartur

(18) Fitimi i tatueshem neto (16-17)

Të ushtrimit

Tatimore

(8)	2,964,458	(9)	2,964,458
(10)	10,172,936	(11)	10,172,936
		(12)	108

(13)	7,208,478	(14)	7,208,370
(15)	0	(16)	0
		(17)	0
		(18)	0

Llogaritja e tatim fitimit

(19) Tatim fitimi me shkallen tatimore standarte

(20) Tatim fitimi me perqindje te tjera

(21) Tatim fitimi (19+20)

(22) Tatim fitimi i shtyre

(23) Tatim Fitimi i detyrueshem për t'u paguar

(19)	0
(20)	0
(21)	0
(22)	0
(23)	0

DEKLARATE

Deklaroj se **Shoqëria GREEN COAST SH.P.K** me NIPT **L41329038D** me administrator Z/Zj. **ELTON GJIKA** dhe **aksionere:**

1. Shoqëria "BALFIN SH.P.K" perqindja e pjesemarrjes 100 %
2. Shoqëria **GREEN COAST SH.P.K** me NIPT **L41329038D** ka hartuar pasqyrat financiare të vitit 2015 komform standarteve kombetare te kontabilitetit.

Hartuesi i pasqyrave financiare eshte Znj Altina DELIU Financiere e punesuar prane kompanise

Administratori i Shoqërisë
(ELTON GJIKA)



Green Coast